



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", ish - hotel "Drini", Tiranë

Tel;04 2268141; Fax: 2268142

Nr. 65/5 Prot.

Tiranë, më 30.03. 2017

V E N D I M

Nr. 63, datë 30.03.2017

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 864/1 prot, datë 09.01.2017”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 864/1 prot, datë 09.01.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së aktit administrativ nr. 5175/10, datë 27.12.2016, i Komisionit Disiplinor, pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për dhënien e masës disiplinore “Mbajtjen e 1/3 të pagës së plotë, për periudhën deri në gjashtë muaj”, për nëpunësen *****.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 864/2, datë 09.01.2017 dhe shkresës nr. 864/3, datë 30.05.2016, u vunë në dijeni Departamenti i Administratës Publike dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për fillimin e këtij verifikimi, si dhe u kërkua nga institucionet, dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e tij.

Gjatë kohës që zhvillohej hetimi administrativ, Komisioneri ka rënë në dijeni të faktit që kjo punonjëse kishte ngritur padi, ndaj institucionit punëdhënës Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Ndodhur në këto kushte, me anë të shkresës nr.178 prot., datë 13.03.2017, iu kërkua Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, një informacion në lidhje me këtë rast.

Kjo Gjykatë nëpërmjet shkresës nr. 2537/1, datë 15.03.2017, “*Kthim përgjigje*”, informon Komisionerin se :

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është duke gjykuar padinë e ngritur prej nëpunëses ***** kundër palës së paditur AKU, me objekt: “*Shfuqizimin e Vendimit nr. 5175/10, datë 23.12.2016, Komisionit Disiplinor të AKU-së, për dhënien e masës disiplinore, “Mbajtjen e 1/3 të pagës së plotë, për periudhën deri në gjashtë muaj*”, për këtë nëpunëse, dhe procesi gjyqësor është në vazhdim.

Sa më sipër konstatoj se, kjo nëpunëse paraqitet si palë paditëse në këtë proces gjyqësor, kundër palës së paditur, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit(AKU) .

Në këto kushte, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, i ndryshuar, dhe në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, ku përcaktohet se, institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësohet se në këtë rast, duhet të vendoset përfundimi i procedimit administrativ.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ligjin 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*” si dhe nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 864/1 prot, datë 09.01.2017, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit administrativ nr. 5175/10, datë 27.12.2016, i Komisionit Disiplinor, pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për dhënien e masës disiplinore “Mbajtjen e 1/3 të pagës së plotë, për periudhën deri në gjashtë muaj*”, për nëpunësen *****.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit(AKU), si dhe kërkuesja, *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA